

Origjina dhe përhapja në Itali e familjes së madhe shqiptare

Më të njohurit autorë të së shkuarës dhe së fundi Giovanni Ferrara në vitin 1980, kanë shkruar gjerë e gjatë për familjen De Florio, për pjesëtarët e feudet e saj, si dhe për privilegjet që kanë pasur. Sa për origjinën e saj, pjesa më e madhe e historianëve bien dakord që Galeotto Franco nga Shkodra, një fisnik nga qyteti i lashtë i Vlorës, nga merr edhe mbiemrin (Vlorë, nga vjen Florë e më pas Florio), dhe pasardhësit e tij qenë padronë deri në shekullin XII. Familja De Florio, ashtu si të tjera, duke qenë "e dëbuar nga barbarët", u vendos, në vitin 1182, fillimisht në Venecia e më pas në të tjera qytete të rëndësishme italiane.

Dihet që mes familjeve që mbështetën nga ana financiare Karlin I Anzhu (1266-85), mbretit i Napolit dhe i Sicilisë, është edhe De Florio në vitin 1275. Rendisim shkurtimisht bëmat e disa prej pinjollëve të kësaj familjeje.

Ish gjeneral i përgjithshëm i mbretit të Sicilisë, Pjetri I i Aragonës (1282-85), Ruggiero me qëndrim në Brindisi, në vitin 1305 arriti një fitore të bujshme kundër turqve nën urdhrat e Karlit II Anzhu, mbretit i Napolit (1285-1309). Gianfilippo, çambelan i mbretit Karli III të Napolit (1381-86), në shpartallimin që pësuan ushtarët e mbretëreshës Zhana I Anzhu (1343-81), arriti të zinte rob burrin e saj, Ottone të Brunswick-Grubenhagen, princ i Tarantos, e për këtë u shpërblye nga mbreti me dhjetëmijë forintë, njëmijë në të holla dhe për nëntëmijë të tjerët iu dha një feud në afërsi të Lecces. Petruccio ishte marsshal i Mbretërisë, dhe nga mbreti i Napolit, Ladislao i Durrësit (1386-1414), u nderua me titullin Zot i Oppido Mamertina në Kalabri (ku ka edhe një rrugë me emrin Florio) dhe Kapiten i Drejtësisë dhe i Luftës së ishullit të Liparit, në fillim të shekullit XIV. Giovanotto ishte feudal i San Dionisio e Persano në Terra d'Otranto (Puglia).

Fisnikëve Jannuccio dhe Dante, në vitin 1437, iu lejua përvetësimi i tatimit mbi pjesën e tretë të vlerës së hekurit të nxjerrë. Në vitin 1442, fis-



Foto Giovanni Armillotta

E para nga lart:: Stema hijerëndë e familjes De Florio në rrugën San Lorenzo

E dyta: Dhjetë harqet e pallatit të parë De Florio e parë nga shëtitorja Roma

E treta : Pallati i dytë De Florio, i parë nga shëtitorja Manfredi

Në faqen përmbri: Stema De Florio që ndodhet në qemerin e hyrjes së pallatit të parë në rrugën Santa Chiara

Edhe sot e kësaj dite mund të admirohet stema madhështore e De Florio-ve, mbi të cilën qëndron shqiponja dykrenore e Skënderbeut: diçka mjaft e rrallë, ekzistenca e të cilës ndoshta nuk dihet në Shqipëri.

Familja shqiptare e Kontëve De Florio në Manfredonia

Nga Giovanni Armillotta

nikut Costantino, për shërbimet e ofruara, iu njoh e drejta e mospagimit të tatimeve mbi korrjet e mëse 40 karrucave me grurë; ky privilegj u la në fuqi edhe për pasardhësit e trashëgimtarët e tij. Në vitin 1476 Dario u emërua Konsull në Ragusa. Në vitin 1504, vëllezërve Dionisio, Giorgio dhe Scipione iu konfirmua përvetësimi i "të tretës së hekurit" të sipërpërmendur. Në vitin 1524, Francesco dhe Costantino morën miratimin mbretëror për shitjen që ata i bënë "të tretës së hekurit" të sipërpërmendur në favor të markezit Girolamo Pellegrino.

Familja De Florio e Manfredonias dhe pallatet e saj

Me pushtimin turk në gusht 1620, Manfredonia u shkrumbua, autoritetet dhe qytetarët, të detyruar të largoheshin, braktisën gjithçka. Të gjitha dokumentet dhe sendet e çmuara, të Universitetit, të Selisë kryepeshkvnore dhe të

zyrave publike u shkatërruan. E kështu edhe historia e familjes, që secila mbronte me xhelozë e që përfaqësonte dekorin e Manfredonias, për fat të keq humbi njëherë e përgjithmonë.

Historiani Michele Bellucci në një dorëshkrim të tijin të pabotuar të ruajtur në Arkivin Historik të Komunës së Manfredonias shkruan: "Në një kartë të familjes De Florio ka një mbishkrim, mermeri për të cilin u diktua nuk ekziston. Mbishkrimi sjell stemat fisnike të familjes, të cilave Francesco Saverio De Florio, i biri i Giacomo, në vitin 1720, shtoi mbi pendët e përkrenares, e në pjesën qendrore të stemës, një shqiponjë dykrenore, të dhënë nga perandori Karli V për bëmat fisnike gjatë luftës familjes, së cilës, pikërisht pse ishte fisnike e trime, më parë Ladislao e Karli III, mbretit i Napolit, i kishin dhënë të drejta, privilegje dhe imunitet".

Familja De Florio kishte dy

pallate: njëri me fasada në rrugën Santa Chiara, ku është edhe hyrja, e në shëtitoren Roma; tjetri me hyrje në rrugën De Florio, sheh edhe mbi shëtitoren Manfredi.

I pari, në rrugën Santa Chiara, është i stilit barok, me ballkone të mbajtur nga ancakë me dredhë të dyfishtë dhe me kangjella mbrojtëse me profil të lakuar. Portikati, më i vonë se pallati, është i një linje të pastër klasike; ka fasadën kryesore mbi shëtitoren Roma, dhe përbëhet nga një seri prej dhjetë harqesh gjysmërrethore të mbështetur mbi kolona me seksion drejtkëndor me korniza të thjeshta. Portikati mbulohet nga një seri qemeresh kryq. Stema e familjes e vendosur në qemerin e hyrjes që sheh nga rruga Santa Chiara është e dëmtuar nga koha e moskudesi i pronarëve. Ndërsa stema hijerëndë e De Florio-ve, mbi një lastër të fortë guri, është vendosur mbi fasadën e ish manastirit të Santa Chiara-s në rrugën San Lorenzo, përballë fasadës anësore të pal-



latit.

Pallati i dytë, në rrugën De Florio dhe shëtitoren Manfredi, është më i vonë e paraqet motive arkitekturore më aktuale. Për vite me radhë ka qenë selia e Bibliotekës komunale të Manfredonias.

Isabella dhe Kisha e Manastiri i Santa Chiara-s

Fisnikja Isabella De Florio, e mbetur e ve që në moshë të re, në vitin 1592 ofroi kamjen e saj për ndërtimin e kishës Santa Chiara dhe të manastirit të shtuar, e inkurajuar nga Kardinali Domenico Ginnasio, kryeipeshkv i Manfredonias (1586-1607). Themeluesja e devotshme u bë murgeshë në të njëjtin kuvend dhe mori emrin Motër Antonia, duke vendosur që njëra nga pasardhëset e familjes De Florio të mund të bëhej murgeshë, pa pajë, në atë manastir. Ajo pa lulëzimin e institucionit të saj në të cilin hynë menjëherë tridhjetë vajza nga familje të mira. Isabella vdiq në vitin 1625. Më pas manastiri u bë Seminari kryeipeshkvnor i Zembrës së Shenjtë. Në fasadën mbi rrugën San Lorenzo edhe sot e kësaj dite mund të admirohet stema madhështore e De Florio-ve, mbi të cilën qëndron shqiponja dykrenore e Skënderbeut: diçka mjaft e rrallë, ekzistenca e të cilës ndoshta nuk dihet në Shqipëri.

Giacomo e Teatri i Manfredonias

Në vitin 1708 aristokrati Giacomo De Florio, me qëllimin që të rinjtë t'i përkushtoheshin artit skenik, investoi për ndërtimin e një "teatri të rehatshëm dhe të admirueshëm", të pajisur me perde, skena të lëvizshme dhe në sfond, të punuara në mënyrë të përsosur, ndërrimi i të cilave kryhej me shpejtësi. Mësimdhënia u ish besuar mësuesve me vlerë, të zotët në vënie në skenë të shfaqjeve teatrale. Në kujtim të teatrit, Komuna e quajti sheshin Largo Teatro Vecchio, hyrja në të cilin bëhet nga rruga Maddalena: sheshi është i mbyllur nga ndërtesa në tre anë dhe i hapur vetëm në krahun e rrugës. Mendohet që fasada e Teatrit të ndodhej në paretin në ballë të sheshit, nga ana e detit.

Pallati Castriotta në Manfredonia

Giovanni Armillotta

Në numrin e janarit të Shqiptarit të Italisë lexuam se Manfredonia, mes bijve të saj të nderuar kishte edhe Gjeneral Brigadierin e famshëm Raffaele Castriotta. Ai ishte pasardhës i njëris prej familjeve shqiptare që i dhanë prestigj qytetit puljez dhe mbarë Italisë. Po ndalem pak në pallatin ku ai ka banuar.

Gjatë periudhave të shkurtra të lejeve ushtarake gjatë karrierës së tij dhe së fundi në vitet e pleqërisë, Gjeneral Brigadier Raffaele Castriotta jetoi në pallatin e tij, fasadat e të cilit ngrihen mbi rrugën Campanile dhe mbi shëtitoren Manfredi në qendër të qytetit.

Në rrugën Campanile ka një portë monumentale dhe hijerëndë, me një gjys-



mehark në pjesën e sipërme. Muri përçark portës është i përbërë nga gurë në formë drejtkëndëshash të rregullt, me sipërfaqe të punuar në relief me motive harmonike baroke.

Ballkoni i madh e madhështor këndor është i stilit gotik, i mbajtur nga nëntë ancakë të mëdhenj në gur, ku ai qendrori, në qoshe të rrugës, është me dredhë të trefishtë, ndërsa të tjerët me dredhë të dyfishtë. Dy fasadat mbyllen në pjesën e sipërme me një buzë leheje shumë të thjeshtë.

Lart: Porta monumentale e parë nga rruga Campanile

Poshtë: Ballkoni me nëntë ancakët i parë nga shëtitorea Manfredi

Foto G. Armillotta